

EKIPI I KOORDINIMIT TË PROJEKTIT

Regional Environmental Center for Central and Eastern Europe, Hungari

Instituto de Engenharia Mecânica – Faculdade de Engenharia da Universidade do Porto, Portugali

National Institute of Environmental Health, Hungari

Joint Research Centre, Institute for Health and Consumer Protection, KE

PARTNERËT E PROJEKTIT

Instituti i Shëndetit Publik, Shqipëri

Institute of Environmental Health, Medical University of Vienna, Austri

Planning and Coordination Substances and Analysis, Umweltbundesamt GmbH, Vienna, Austri

Flemish Institute for Technological Research, Belgjikë

Public Health Institution of the Federation of Bosnia and Herzegovina

National Center for Public Health and Analysis, Bullgari

Larnaca General Hospital, Qipro

Cyprus State General Laboratory
National Public Health Institute,
Republika Çeke

Health Board, Estoni

National Institute for Health and Welfare, Finlandë

Université Pierre et Marie Curie Paris 06, Francë

Centre Scientifique et Technique du Bâtiment, Francë

Umweltbundesamt, Gjermani

University of Western Macedonia, Greqi

National Kapodistrian University of Athens, Greqi

Università degli Studi di Milano, Itali

Università degli Studi di Siena, Itali

National Research Council, Institute of Biomedicine and Molecular Immunology, Palermo, Itali

Fondazione Salvatore Maugeri, Itali

Kaunas University of Technology, Lituani

University of Malta

Netherlands Organisation for Applied Scientific Research

Public Health Service Gelderland Midden, Hollandë

Rijksinstituut voor Volksgezondheid en Milieu, Hollandë

Norsk Institutt for Luftforskning, Norvegji

Institute of Occupational Medicine and Environmental Health, Poloni

CESAM and University of Aveiro, Portugali

Babes-Bolyai University, Rumani

Institute Vinca, Serbi

Medical Center Dr Dragisa Misovic, Serbi

Autoriteti i Shëndetit Publik të Republikës së Sllovakisë

Uppsala University, Suedi

University College London, MB

Zyrat Vendore të Qendrës Rajonale të Mjedisit në Shqipëri, Bosnje-Hercegovinë dhe Serbi

PARTNER KANDIDAT

Hainaut Public Health Institute, Belgjikë



KONTAKTET

Qendra Rajonale e Mjedisit (REC),
Zyra për Shqipërinë,
Rruga Ismail Qemali, Nr. 27,
Tiranë

Tel: +355 4 2 23 29 28

Faks: +355 4 2 23 29 28

E-mail: rec.albania@rec.org


www.sinphonie.eu

www.rec.org

<http://albania.rec.org>



Health & Consumer Protection
Directorate-General



Ta kthejmë hulumtimin në veprim

Rekomandime për një mjedis të shëndetshëm të shkollave në Evropë





Të kapërcejmë sfidën

Projekti SINPHONIE (Ndotja e Brendshme në Shkolla dhe Shëndeti: Rrjeti Vëzhgues në Evropë), që mbështetet nga Parlamenti Evropian dhe bashkërendohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Komisionit Evropian për Shëndetin dhe Konsumatorët (EC DG SANCO), është projekti i parë pilot për të monitoruar parralelisht mjedisin e shkollave në 25 vende evropiane. Një kuptim më i gjerë i ekspozimit të fëmijëve ndaj ndotësve të veçantë të ajrit në mjediset e brendshme dhe vlerësimi i rreziqeve shoqërore, janë kushte paraprake për të ofruar rekomandime për politikën. Hulumtimet e kësaj natyre përfshijnë vlerësimin e mjediseve të brendshme; ndërmarrjen e vlerësimeve toksikologjike të rreziqeve kimike; dhe monitorimin e ndikimeve mbi shëndetin që kanë të bëjnë me mjedisin e brendshëm.

Shpërndarja e rezultateve bëhet përmes aktiviteteve të ndryshme gjatë të gjithë projektit duke përfshirë nxënësit, mësuesit, personelin e shkollave dhe prindërit, duke krijuar kështu një sjellje pro-aktive për të pasur një cilësi ajri të brendshëm më të mirë në shkolla e si pasojë edhe në shtëpi.


Për të vazhduar partneritetin unik ndërmjet mjedisit dhe hulumtimit mbi shëndetin, partnerët e projektit SINPHONIE, janë angazhuar ta vazhdojnë projektin për të fituar përvojë më të gjerë në hulumtimet mbi cilësinë e ajrit të brendshëm dhe shëndetin e fëmijëve në Evropë. Rezultatet e projektit SINPHONIE kanë ngritur pyetje të reja për hulumtimet, në lidhje me materialet e shëndetshme për ndërtimin e shkollave, komfortit të fëmijëve dhe ajrosjes së shkollave. Partnerët e projektit do të aplikojnë për financim nga BE-ja për ta përfunduar hulumtimin mbi cilësinë e ajrit të brendshëm dhe grumbullojnë më shumë prova, të cilat do të kontribuojnë në zhvillimin e politikave shëndetësore në shkolla.

Projekti SINPHONIE në veprim

Projekti SINPHONIE është një projekt kompleks hulumtimi i përqendruar në marrëdhënien ndërmjet mjedisit dhe shëndetit, e që ka si qëllim kryesor përmirësimin e cilësisë së ajrit në shkolla dhe kopshte.

Projekti SINPHONIE është hartuar të vazhdojë për dy vjet dhe partneriteti është i përbërë nga 38 partnerë nga 25 shtete, dhe një partner kandidat. Të gjithë partnerët kanë ekspertizën shkencore dhe mundësinë për t'i shpërndarë rezultatet e projektit tek aktorët, përfshi hartuesit e politikave, projektuesit e ndërtesave, ndërtuesit, menaxherët dhe përdoruesit e ndërtesave, veçanërisht mësuesit dhe nxënësit. Projekti është zbatuar nën kontratën e shërbimit të KE-së (DG SANCO).

Duke u përqendruar në shkolla dhe vendet e kujdesit për fëmijët, projekti synon të mbështetet mbi njohuritë ekzistuese dhe të zgjerojë gamën e informacionit në dispozicion, duke mbuluar shtetet anëtare të reja dhe të vjetra të BE-së dhe disa shtete candidate duke përdorur procedurën standardizuar për të prodhuar një kuadër politikash, udhëzimesh dhe praktikash të mira që sigurojnë mjedisin më të mirë të brendshëm për fëmijët në shkolla në të gjithë Evropën.





Bojërat dhe ngjitësit

Lëndë kimike

Materialet e ndërtimit

Pirja e duhanit

Tymrat nga trafiku



Vlerësimi i rrezikut

BURIMET E NDOTJES

Në Evropë, nxënësit, mësuesit dhe personeli i shkollave i përdorin ndërtesat e shkollave për pjesën më të madhe të ditës. Nxënësit rrezikohen nga ndotja e ajrit të brendshëm si rezultat i burimeve ndotëse, përfshi aktivitetet. Projekti SINFONIE ka dalluar probleme të shpeshta të cilësisë së ajrit të brendshëm në shkollat evropiane për shkak të ajrit të jashtëm të ndotur, ndërtimeve dhe mirëmbajtjes së keqe të ndërtesave, pastrimit të keq dhe ajrimit të keq.

Cilësia e ajrit të brendshëm ndikohet nga burime të ndryshme ndotëse dhe mund të përmirësohet përmes kontrollit të këtyre burimeve dhe ajrimit efikas. Burimet kryesore të ndotjes së ajrit të brendshëm janë ndërtimi i ndërtesave dhe materialet që përdoren për zbukurim, mobiliet dhe veprimtaritë e personave që i banojnë këto ndërtesa (p.sh. pirja e duhanit, produktet e pastrimit, bojërat, ngjitësit dhe produkte të tjera të konsumatorëve si dhe prodhimi i lagështirës dhe CO2). Faktorë të tjerë kryesorë kontribues të jashtëm janë ndotja nga trafiku dhe ndotja industriale, si dhe llojet e tokës mbi të cilën është ndërtuar shkolla.

NDIKIMET MBI SHËNDETIN

Ndotësit e zakonshëm të brendshëm në shkolla janë grimcat e pluhurit, oksidet e azotit, përbërje të paqëndrueshme organike, formaldehide, agjentë biologjikë të tillë si alergjenë të brendshëm (nga morrat e bimëve, macet, qentë, furrtalet dhe kërpudhat), myket, viruset dhe bakteret. Këta ndotës të ajrit mund të gjenden në klasa, në disa raste në përqendrime të larta, shpesh më të larta se në mjedisin e jashtëm.

Si rezultat, cilësia e ajrit të brendshëm në shkolla mund të çojë në shqetësime, irritime dhe probleme shëndetësore të ndryshme afatshkurtra dhe afatgjata; rëndime të problemeve shëndetësore ekzistuese, përfshi astmën dhe alergjitë; shpërndarjen e sëmundjeve infektive të transmetueshme nëpërmjet ajrit; ulje në prodhimtarinë e personelit dhe nxënësve; dhe rritje të mungesave.

Fëmijët rrezikohen edhe më shumë nga problemet që kanë të bëjnë me cilësinë e ajrit të brendshëm, veçanërisht ata që vuajnë nga alergjitë, astma ose mbi-reagimi i rrugëve të frymëmarrjes.

Menaxhimi i rrezikut

MJEDISI I SHKOLLËS

Cilësia e ulët e ajrit të brendshëm mund të prekë frymëmarrjen dhe shëndetin e përgjithshëm të nxënësve dhe personelit të shkollës, dhe mund të ndikojë edhe mbi mirëqenien e tyre të përgjithshme. Në dekadat e fundit është dokumentuar një rritje mbizotëruese e astmës bronkiale në botën e industrializuar, përfshi Evropën. Fëmijët astmatikë dihet se janë tejet të ndjeshëm ndaj ndikimeve të ajrit me cilësi të dobët. Shkollat janë mjedise kritike për segmentet e prekshme të popullatës, si për shkak të sasisë së kohës që kalohet aty ashtu dhe për shkak të mungesës së kujdesit që i kushtohet mjediseve të brendshme apo të jashtme. Kjo do të ndihmojë për të shpjeguar një sasi të madhe provash mbi ndikimet, mundësisht të dëmshme, mbi shëndetin të një numri ndotësish të brendshëm që gjenden në mjediset e shkollave.

TREGUESIT

Për të kuptuar më mirë ndikimin e masave për të përmirësuar kushtet e përgjithshme të mjedisit (përfshi higjienën) në shkolla, dhe për të përlogaritur kostot e përfshira, janë përcaktuar katër kritere:

- Efikasiteti – analizimi i ndryshimeve të mundshme dhe të pritshme për sa i përket rreziqeve dhe ndikimeve.
- Ndër-raporti – kryerja e një analize të kostos dhe përfitimit në lidhje me përmirësimin e shëndetit, duke lejuar autoritetet kombëtare dhe vendore të vlerësojnë masat dhe të gjykojnë më saktësisht përshtatshmërinë e tyre ekonomike.
- Zbatueshmëria – vlerësimi i masës në të cilën udhëzimet dhe rekomandimet mund të zbatohen, imponohen dhe menaxhohen.
- Monitorimi – të shihen ndikimet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të masave të politikave të marra dhe të përgatitet raport i përgjithshëm i kostove të monitorimit.

Duke lejuar një analizim më të thellë në kostot dhe përfitimet e masave të mundshme, këto kritere do të mbështesin edhe caktimin e përparësisë së masave të mundshme në vendet evropiane. Një grafik i ndryshimeve të nevojshme dhe mbulimit financiar për to duhet diskutuar me personelin dhe pronarët e shkollave.

Rekomandime për një mjedis të shëndetshëm të shkollave në Evropë



Ajrimi

Pastrimi

Bojëra me emetime të ulëta

Produkte me etiketa ekologjike

Ndërtesa të shëndetshme

Rekomandime për politikën e përgjithshme

Bazuar në rishikimin e udhëzimeve dhe rekomandimeve kombëtare, ka pesë kategori të sugjeruara të matjes, për të arritur një mjedis të brendshëm të sigurt dhe të pastër në shkollat evropiane:

RRITJA E NDËRGJEGJËSIMIT

Higjiena e brendshme mund të përmirësohet shumë duke edukuar personelin e shkollës, personelin pastrues, prindërit dhe nxënësit. Kjo kërkon rritje të strukturuar të ndërgjegjësimit – që do të thotë një mekanizëm që përsëritet gjithnjë gjatë një periudhe kohe dhe jo vetëm në situata të veçanta. Edukimi për pastrimin, praktikat e mira të higjienës dhe karakteristikat e produkteve të veçanta të ndërtimit mund të ndikojnë mbi sjelljen dhe të çojnë në përmirësimin e shëndetit. Tymrat prodhojnë lëndë kimike të rrezikshme. Në shkolla duhet zbatuar ndalimi i pirjes së duhanit.

PROCEDURAT DHE SHPESHTËSIA E PASTRIMIT

Pritet që pastrimi, ndërkohë që kushton më pak se gjërat e tjera, të japë kontributin më të madh për të parandaluar shpërndarjen e sëmundjeve ngjitëse. Duhet bërë kujdes në lidhje produktet e pastrimit të përdorura dhe kohën e përdorimit - ato nuk duhen përdorur përpara se të fillojë mësimi!

PËRDORIMI I PRODUKTEVE DHE MATERIALEVE

Duke njohur se cilat materiale ndërtimi, veshje dhe produkte të tjera përmbajnë dhe mund të lëshojnë ndotës, mund të merren vendime të bazuara në njohuri për të shmangur përdorimin e disa produkteve dhe për t'i zëvendësuar ato me të tjera që nuk çojnë në uljen e cilësisë së ajrit të brendshëm, si dhe zvogëlojnë rreziqet ndaj shëndetit.

AJRIMI

Ajrimi i mirë në klasa ka treguar se ul përqendrimin e CO2 në ajrin e brendshëm, duke përmirësuar kështu aftësinë e fëmijëve për t'u përqendruar dhe për të mësuar. Përqendrimet e ndotësve të ajrit të brendshëm janë më të ulët edhe atje ku sigurohet ajrimi i mirë (ose duke hapur dritaret ose me një sistem mekanik).

NDËRHYRJET TEKNIKE

Ndërtesat e reja të shkollave mund të projektohen, ose (pjesë) të ndërtesave ekzistuese mund të rinovohen, duke i kushtuar kujdes të veçantë zgjidhjeve për higjienën e brendshme dhe ajrimin e duhur.

Këshilla për shkollat

Specialistët e përfshirë në projektin SINPHONIE kanë dhënë një listë këshillash praktike për personelin e shkollës, mësuesit dhe fëmijët për të pasur një mjedis më të shëndetshëm.

PASTRIMI

- Zgjidhni produkte pastrimi që ndotin më pak (që kanë një etiketë ekologjike).
- Organizojeni pastrimin në gjithë vendet e shkollës në fund të ditës së mësimin, dhe jo pak përpara ditës së mësimin.

ZVOGELIMI I BURIMEVE TË NDOTJES

- Zgjidhni materiale të përshtatshme përpara se të filloni punime rinovimi ose mirëmbajtjeje. Përpiquini të përdorni ekspozim të kufizuar ndaj materialeve të ndërtimit që përmbajnë substanca që kanë lidhje me astmën ose sëmundje të tjera të frymëmarrjes.
- Kontrolloni nëse mund të përdoren bojëra me emetim të ulët (p.sh. bojëra me bazë uji) dhe jo vernik. Nëse përdorni vernik, përpiquini të përdorni llojet që ndotin pak.
- Pas rinovimit, në ajrin e brendshëm në përgjithësi mund të dallohen përkohësisht nivele të përbërësve organik të paqëndrueshëm. Kjo ndotje mund të ulet përpara duke përdorur materiale të duhura ndërtimit dhe duke rritur ajrimin.

AJRIMI

- Hapni dritaret shumë përpara se të filloni ditën e mësimin dhe gjatë çdo pushimi.
- Nëse hapja e dritareve nuk siguron ajrim të mjaftueshëm, mund të nevojitet një sistem mekanik shtesë për të siguruar ajër të brendshëm me cilësi.
- Ajrimi i efektshëm është kyç për të siguruar komfort në ditët e ngrohta, parandalon krijimin e mykut, dhe zvogëlon përqendrimin e ndotësve në mjediset e brendshme, si për shembull grimcat e pluhurit, përbërësit organik të paqëndrueshëm, CO2, etj.

Informacion më të bollshëm mbi aktivitetet e projektit mund të gjeni në internet (www.sinphonie.eu).